



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 7317 /2019

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12, 40, Ligjit Nr. 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, neni 3, paragrafi 1.40, 1.41, neni 16 paragrafi 1, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 27, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.08.2019 merr:

VENDIM
PËR RIALOKIM DHE TRANSFER TË MJETEVE NË KATEGORINË EKONOMIKE SHPENZIME
KAPITALE

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për rialokim dhe transfer të mjeteve në kategorinë shpenzime kapitale.
2. Rialokimi dhe transferi në total është në shumë prej 293,726.56 € nga fondet 10, 21 në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale sipas tabelave 4.1 dhe 4.2 të bashkangjitur këtij vendimi.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL, si dhe pas publikimit në webfaqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e Drejtorive,
- Ministria e Financave - Departamenti i Buxhetit,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 27. 08. 2019

Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava





01/Nr.6910/2019

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike 03/L-048 neni 45.4, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 64, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.08.2019 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUdhËN JANAR-QERSHOR PËR VITIN 2019

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin e shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar -Qershor për vitin 2019.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar- Qershor 2019 i hartuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa. Buxheti i miratuar për vitin fiskal 2019 është në shumë prej 2,915,921.00 €, ndërsa ai përfundimtar është 3,203,142.56 €. Në kategorinë paga dhe mëditje janë shpenzuar 732,417.71 € apo 49.05 %, për mallra dhe shërbime 103,694.46 € apo 39.92 %, për shpenzime komunale 21,600.23 € apo 39.71 %, për subvencione dhe transfere 50,333.80 € apo 75.99 % dhe për shpenzime kapitale 208,614.99 € apo 15.69%. Totali i shpenzimit është në shumë prej 1,116,661.19 € apo 34.86 %. Komuna e Hanit të Elezit ka arritur t'i arkëtoj gjithsejtë 169,938.08 € të hyra vetanake për periudhën janar-qershor 2019 apo 58.78 % e planit të të hyrave vetanake.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 27.08.2019

